

Angjelina HAMZA-HASANAJ

ROLI I GRUAS NË FAMILJE E SHOQËRI NË MES TRADITËS DHE MODERNES

Të shkruash sot për jetën e gruas në Kosovë duke bërë krahasime nga e kaluara historike dhe kulturore, nuk është aspak e lehtë, ngase çfarëdo që përpiqemi të trajtojmë në jetën e saj, paraqet ndjeshmëri studimi. Përplasjet e gruas me jetën dhe sfidat e saj në mjedisin kosovar, pa mëdyshje se paraqesin një sfond temash me interes trajtimi antropologjik, sociologjik, kulturor, historik dhe ekonomik në çdo periudhë kohore. Studimi i jetës dhe i pozitës së gruas në familje dhe në shoqëri është një çështje mjaft e rëndësishme, veçmas kur studimi bëhet në segmente të caktuara dhe të ndjeshme të jetës së tyre. Pozita e gruas në Kosovë, i takon një procesi mjaft unik të zhvillimit në çdo periudhë të jetës së saj. Vështirësitë e jetës e bënë figurën e gruas kosovare më unike dhe në njëfarë forme ikonë të luftës, traditës e të çdo simboli të forcës njerëzore.

Prandaj, për t'i trajtuar problemet shoqërore, historike, psikologjike, kulturore të një populli apo të një kulture e vendi, mund të zbatohet metoda krahasuese në dy mënyra kryesore: "...ta fillojmë studimin prej së largu, prej të kaluarës për të arritur deri te situata aktuale, ose ta marrim si pikë fillestare momentin aktual, për të arritur deri te burimet, për ta kuptuar sa më shumë situatën e sotshme".¹ Pikërisht, duke u nisur nga kjo që themi, në këtë punim studimor, në formë kronologjike dhe përmbledhëse janë trajtuar disa elemente të jetës së gruas në traditë si dhe ato në modernitet, pra sfidat e tyre në mes të këtyre dy kohërave.

¹ Lush Gjergji, *Roli i femrës shqiptare në familje dhe në shoqëri*, Radosna Vijest, Sarajevë 1977, 10.

Pozita e gruas në familje dhe shoqëri ruan aktualitetin trajtues, për vetë faktin së përbën njërën nga dy shtyllat e ngritjes dhe zhvillimit familjar dhe atij shoqëror. Nga ky këndvështrim ajo me vlerat e saj krijuese është bërë temë e trajtimeve nga më të ndryshmet, socio-kulturore dhe teorike, veçmas në shkencat humane dhe shoqërore. Ndërkaq, në shoqëritë e ndryshme, sidomos ato tradicionale, por edhe në ato në tranzicion siç është shoqëria kosovare, gruaja është trajtuar (herë më shumë, e herë më pak) si pjesëtare e gjinisë dytësore në raport më meshkujt. Prandaj, në këtë punim studimor, fokusi ynë është mjaft i gjerë dhe kompleks, kur bëhet fjalë për “udhëtimin e grave” në mjedisin shoqëror kosovar përmes rrjedhave dhe fazave socio-ekonomike dhe politike, si dhe të rrethanave tradicionale e patriarkale të cilat rrodhën si pasojë e ndikimeve të ndryshme në shoqërinë tonë. Ndikime këto që përmbliidhen në disa periudha historike të cilat ndikuan më së shumti.

Një çështje me rëndësi gjatë kësaj periudhe e kemi edhe zbatimin e normave të Kanunit të Lekë Dukagjinit, ndikimi i të cilit në këtë periudhë ishte vendimtar dhe kryesori në shoqëri edhe në familje. Pozita e vështirë e gruas, në jetën patriarkale si dhe në përgjithësi të shoqërisë, raportet shoqërore dhe ato familjare, ishin të mbështetura mbi dispozitat dhe normat kanunore. Normat e këtij kanuni ishin ato të cilat në veçanti gruan e diskriminonin më shumë. Duke filluar nga varësia e saj te babai, mandej te vëllai, marrja e vendimeve për të nga farefisi dhe mandej nënshtrimi i saj në martesë nga burri dhe anëtarët e tjerë të familjes.

Për ligjet e këtij kanuni në vazhden e rrjedhave historike thuhet se, herë konsiderohet si një ndër ligjet më të mira në Ballkan në kohën e zbatimit dhe ekzistimit të tij, herë të tjera ai mbetet si një ligj jo shumë i pëlqyer nga shoqëria. Pra, varësisht nga cili këndvështrim historik shikohet, pranohet e bëhet analizimi e vlerësimi i tij. Konsiderohet që ky kanun dhe të tjerët mbas tij, të janë pëlqyer dhe zbatuar nga shoqëria për faktin e mungesës së një shteti dhe ligjeve të vendosura për shoqërinë. Prandaj edhe mënyra e jetës ka funksionuar duke u mbështetur në këtë kanun. Duke u bazuar në literaturën shkencore ku trajtohen çështjet e zhvillimit dhe ndryshimeve historike në jetë e familje, po ashtu edhe të gruas, e kemi të njohur faktin se kanë ekzistuar disa periudha të zhvillimeve historike në jetën e gruas në Kosovë. Periudha e parë përfshinë shek. XIX-XX, e cila ishte e fokusuar kryesisht në të drejtat e gruas në votim, angazhimet e saj për

arsimim dhe punësim. Periudha e dytë fillon nga vitet e '60-ta, e cila ishte e përqendruar në të drejtat ligjore e kulturore të gruas. Ndërsa, periudha e tretë fillon prej viteve të '80-ta dhe vazhdoi deri në fillim të shek. XXI, periudhë e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite për të kërkuar fuqizimin e gruas në familje e në shoqëri, qoftë e martuar apo si grua e vetme. Kur trajtohet jeta e gruas shqiptare në Kosovë në përgjithësi, sfidat e jetës së saj në të kaluarën dhe gjatë historisë së zhvillimit shoqëror e kulturor, më sjellin në kujtesë fjalët e gjyshërve tanë, se: kur lind vajzë, *qajnë edhe muret e shpisë*.

Pozita e gruas në familje dhe shoqëri në këndvështrimin e disa studiuesve

Historikisht është i njohur fakti që roli i gruas në familje por dhe shoqëri ishte i madh, edhe pse, "...mbi shpatullat e gruas shqiptare gjatë historisë rëndoi pesha e padrejtë e mentalitetit patriarkal, e diskriminimit gjinor, religjioz e zakonor, të cilat u shprehën në të gjitha fushat e jetës" së saj.² Në bazë të këtyre ndikimeve, "gruaja shqiptare u gjend në një pozitë tejet të vështirë. Mbi jetën e saj siç edhe e dimë, rëndonte e drejta zakonore, të drejtat fetare si ajo kanonike për besimtarët e krishtera si dhe sheriatit për myslimanet".³ Një gjë e tillë ishte e theksuar sidomos në rajonet e thella të vendit.

Disa nga elementet e traditës që e kanë shoqëruar dhe vështirësuar jetën e gruas, ishte fakti që ajo nuk e gëzonte të drejtën e pronësisë, të drejtën e trashëgimisë, të drejtat politike e as të drejtën prindërore. Ajo për një kohë shumë të gjatë nuk mund të merrte vendimin qoftë për fejesën apo martesën e fëmijëve të saj dhe vendime të tjera. Pra, "...gruaja nuk zotëronte asgjë, madje shpeshherë as vetveten e saj".⁴ Gruaja e traditës, siç u përmend, fillimisht i nënshtrohej vullnetit të babait, vëllezërve, kushërinjve, pra jeta e saj varej prej tyre. Gruaja në traditë konsiderohej tepricë në shtëpi, prandaj edhe lindja e vajzës nuk pritej pothuajse asnjëherë me dashamirësi. Vajzat, në familje, konsideroheshin të huaja, dhe "për derë të huaj". Vajza nuk kishte të drejtë ta zgjedhte fatin e vet. Fejesa

² Hajrullah Koliqi, *Gruaja ndër shekuj, Arsimimi dhe emancipimi i saj*, Libri shkollor, Prishtinë 2009, 206.

³ Po ty, 273.

⁴ Po aty.

e saj bëhej me ndërmjetësim apo mesitni. Gruaja e martuar përgjatë traditës, nuk kishte të drejtë shkursorëzimi, ndërkohë që burri e kishte atë të drejtë. Gruaja duhej të ishte besnike dhe zbatuese e urdhrave të burrit. Ajo ishte e dedikuar vetëm për të punuar dhe për të lindur sa më shumë fëmijë. Duke u bazuar në këto dhe elementë të tjerë të traditës në raport me gruan, themi se këto ndër të tjera, ishin faktorët plotësues që ta rrisnin skllavërimin e gruas shqiptare përgjatë traditës.

Udhëpërshkruesit e ndryshëm, në periudha të ndryshme kohore, kanë realizuar udhëtime e hulumtime nëpër vende të ndryshme nëpër trojet tona, nga aty kanë sjellë edhe pikëpamjet e tyre në lidhje me atë që kanë parë në trajtimin e gruas në familje e në shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Këto përshkrime i ka pasqyruar edhe etnologja Drita Halimi-Statovci, në një punim të sajën duke i sjellë në formën si ata i kanë parë gratë shqiptare, pa dhënë ndonjë koment më të detajuar nga ana e saj për komentet e tyre për ato gra. Disa nga përshkrimet e gruas shqiptare nga udhëpërshkruesit e huaj e pasqyrojnë në këtë mënyrë: “Kapiteni J.J Best, kishte pasur rast të bëjë një ekskursion interesant në Shqipëri gjatë kohës sa ishte me detyrë në Korfuz. Nga kjo shëtitje ai boton udhëpërshkrimin me titull *Excursion in Albania* (Ekskursioni në Shqipëri), Londër, 1842. Duke vërejtur jetesën e grave shqiptare, Best shënon se ngarkesat (barrët) që mbajnë gratë shqiptare janë tepër të mëdha. Në të vërtetë, Best thotë se kishte parë gra shqiptare me barrë në kokat e tyre ose me barrë mbi supet, të cilën barrë është vështirë të parashihet që ta mbajë një mashkull i fortë”.⁵

Mendime dhe parashtrime të tilla për gruan shqiptare ka mjaft edhe nga studiues të tjerë. Ndërkaq, kur jemi te studiuesit e tjerë të cilët kanë realizuar hulumtime në rajonet e ndryshme të Kosovës, posaçërisht në ato rajone ku konsiderohet se kishte jetë më të rendë në brendësinë familjare dhe jetën e gruas, atëherë theksojmë së po të njëjtat përshtypje i kanë fituar edhe disa nga ata studiues. Studiuesja e njohur e kulturës dhe traditës shqiptare Berit Backer, e cila gjatë viteve të ‘70-ta ka bërë hulumtime në Kosovë, përkatësisht në fshatin Isniq (Deçan), ndër të tjera, thekson se: “... gruaja shihet si “subjekt” dhe jo “objekt”, me fjalë të tjera, nëse llogaritet si një individ

⁵ Drita Halimi-Statovci, *Disa udhëpërshkrime anglo-amerikane mbi pozitën e gruas shqiptare*, Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji, Nr-16-1986, IAP, Prishtine 1987, 64.

shoqëror, pavarësisht faktit se ajo nuk ka asnjë pozitë zyrtare, dallimi është i lehtë për t'u kuptuar".⁶

Gjithashtu, Becker shoqërinë kosovare e ka konceptuar si mjaft tradicionale, shoqëri e cila sipas saj, është e përbërë nga dy sfera të ndara por të ndërvarura në ndër veti, atë të burrave dhe atë të grave.⁷ Kjo ndashmëri na jep të kuptojmë se gruaja nuk ka mundur të jetë e pavarur nga dominimi mashkullor. Këtu Becker flet më tepër për një shoqëri tradicionale siç edhe ka qenë dhe vazhdon të cilësohet si e tillë shoqëria kosovare. Të njëjtën gjë e ka vërejtur edhe studiuesja, Janet Reineck, në hulumtimin e saj përgjatë viteve të '90-ta në trevën e Opojës, ku familjen shqiptare e cilëson si mjaft patriarkale. Ajo ka vërejtur se "... nënshtrimi i grave ndaj burrave mund të shpjegohet si "dukje" dhe si "realitet" nga njëra anë, pasqyron hierarkinë aktuale të pushtetit midis burrave dhe grave, ku sjellja e grave kontrollohet drejtpërdrejt nga burrat dhe familja e tyre e gjerë". Nga ana tjetër, është një fasadë për të projektuar një imazh të dëshiruar të solidaritetit familjar ndaj të huajve. Përgjithësisht, ekziston një pajtueshmëri ku burrat duhet të duken superiorë për të mbështetur nderin e familjes së tyre. Në një rast ajo shkruan se: "*Nëse vijnë mysafirët dhe gratë nuk shërbejnë kafënë që i kërkonin, do të dëmtohej autoriteti juaj menjëherë*".⁸

Hulumtimi i këtyre studiueseve i realizuar në vitet e '80-'90-të, e argumenton mjaft qartë pozitën diskriminuese të gruas ku përveç tjerash, ishte kultura patriarkale ajo e cila e kushtëzonte izolimin e gruas nga jeta publike e sociale, prandaj në shtëpi ato ishin të angazhuara vetëm përbrenda rrethit familjar. Në anën tjetër, po ashtu studiuesit shqiptarë, pa dyshim se në studimet e tyre e sollën gruan në rolin dhe pozitën e saj mjaft të diskriminuar në përbërjen e strukturës familjare tradicionale. Studiuesi Mark Krasniqi, i cili ka studiuar dhe hulumtuar fillimisht familjen e madhe patriarkale shqiptare, ndër të tjera aty ka shpërfaqur edhe pozitën apo rolin e gruas shqiptare në shoqërinë kosovare tradicionale, në këtë rast gruan e paraqet në rolin e zonjës së shtëpisë duke e shpërfaqur në detaje edhe detyrimet e saja në

⁶ Berit Becker, *Behind Stone Walls. Changing Household Organization among the Albanians of Kosova*, Dukagjini, Pejë 2003, 196.

⁷ Po aty, 82.

⁸ Reineck, Janet Susan, *The past as refuge, Gender, migration, and ideology among the Kosova Albanians*, Ph.D. University of California, Berkeley 1991, 98.

raport me gratë e tjera dhe të gjithë familjes. Aty paraqitet hierarkia dhe struktura organizative e familjes me në krye të zotin e shtëpisë apo kryefamiljarin. Ndërkaq, studiues të tjerë në vazhdimësi e sjellin gruan në trajtim, kryesisht si bashkëshorte, nënë dhe kujdestare e familjes, por shumë rrallë gruan në rolin udhëheqës të familjes.

Sa i përket rëndësisë së studimit të mënyrës së jetës, kulturës si dhe rolit të gruas shqiptare në zhvillimin e shoqërisë në Kosovë, por në një këndvështrim më pozitiv, studiuesi Kadri Halimi shkruan: *“Shfaqjet etnografike përkitazi me kulturën e gruas shqiptare në familje e në shoqëri, janë temë për një shqyrtim të gjithanshëm shkencor. Gruaja shqiptare e Kosovës gjithmonë ka pasur një rol kulturor të rëndësishëm në familje. Gruaja shqiptare, nga cilido konfesion qoftë, është burim frymëzimi në punë dhe në jetën e përditshme të familjarëve, ndër ta edhe për burrin, ndonëse në dukje ndaj tij është e nënshtruar. Pra figura e gruas zë një vend të spikatur në familje e në shoqëri”*.⁹

Në përgjithësi, studimi i pozitës së gruas është parë në disa këndvështrime. Studiuesja, Valbona Begolli, e cila është marrë me pozitën e gruas në të drejtën zakonore, gjatë periudhës së socializmit, ndër të tjera thekson se: *“Studimi i pozitës së gruas në familje e në shoqëri paraqet interes shkencor, për të dokumentuar në mënyrë të gjallë e të hollësishme rrugën, nëpër të cilën po kryhen ndryshime për ndërtimin e vendit”*.¹⁰

Gruaja çdoherë vështrohet me e nënshtruar dhe gjithmonë nën udhëheqje të patriarkut apo thënë ndryshe, zotit të shtëpisë, dhe duke u bazuar në të drejtën zakonore, studiuesit dhe hulumtuesit e shumtë, në hulumtimet e tyre e kanë paraqitur gruan në përgjithësi (pa ndarje vendi apo rajoni), gjithnjë inferiore dhe të nënshtruar nga burri. Pra, në kontekstin tradicional, roli i gruas përqendrohej kryesisht në kujdesin për familjen dhe shtëpinë. Ajo ishte përgjegjëse për gatimin, rritjen e fëmijëve dhe koordinimin e punëve me gratë e shtëpisë. Gruaja tradicionale shpesh kishte një rol mbrojtës duke ndihmuar në ruajtjen e vlerave dhe normave kulturore të trashëguara të familjes.

⁹ Kadri Halimi, *Trajtime dhe studime etnologjike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2011, 17.

¹⁰ Valbona Begolli, *Pozita e gruas në Kosovë më një vështrim të posaçëm në të drejtën zakonore*, Rilindja, Prishtinë 1984, 9.

Ndryshimet në jetën e gruas - ndikimi i modernitetit

Sa komplekse po aq edhe me interes, kjo tematikë ngërthen funksionimin e vlerave kulturore shikuar në perspektivë të traditës dhe modernes. Në vazhden e këtyre ndryshimeve, me interes më të veçantë i konsiderojmë ndryshimet e bëra në familjet shqiptare të Kosovës. Këto ndryshime janë evidente gjithashtu edhe në zonat rurale. Interes të veçantë paraqet studimi i ndryshimeve në jetën familjare, pozita e gruas brenda familjes, pjesëmarrja e saj në jetën publike, përfshirë punësimin dhe angazhimin e saj politik e publik. Çështja e pozitës së gruas në shoqërinë shqiptare është kushtëzuar dhe kushtëzohet ende nga shumë faktorë, të cilët janë përmendur në pjesën e parë. Gjithmonë duhet theksuar se as gratë dhe as meshkujt nuk kanë pasur gjithmonë mundësi të zgjedhin për rolet e tilla. Ata janë kushtëzuar nga botanë të cilën kanë jetuar.

Për një kohë të gjatë, ka qenë një problem i madh çështja e raportit dhe e socializmit të gruas së pari me vetveten e mandej me familjen, shoqërinë e me të gjithë rrethin ku jetonte. “Sidomos, lidhur me funksionin tradicional e të pandryshuar të saj si nënë, i cili, pavarësisht intensitetit të ndryshimeve që mund të ndodhin në “rolet tradicionale gjinore”, do të mbetet një mision themelor, i patjetërsueshëm, gati me përcaktim gjenetik, në funksionin edukativ të gruas si nënë”.¹¹ Apo, siç thekson studiuesi, Anthony Giddens, se edhe përkundër faktit që ka ndryshime, por sa i përket rolit të grave dhe burrave, në kultura të ndryshme nuk njihet ndonjë shembull i ndonjë shoqërie, ku gratë të jenë më të fuqishme se sa burrat, kjo nga fakti që gratë janë kudo në botë të interesuara për rritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe sipas Giddens askund në botë nuk ka burra që kanë si përgjegjësi kryesore në rritjen e fëmijëve.¹² Pra, kjo na bën të kuptojmë se e tërë bota është nën ndikimin e patriarkatit dhe nuk mund të konsiderohet vetëm shoqëria shqiptare si tradicionale dhe me ide që bien në kundërshtim me mendësinë e traditës dhe kulturës njerëzore në raport me burrin dhe gruan dhe këtë zotërim të mashkullit Giddens e njeh si patriarkat.¹³

¹¹ Gëzim Tushi, *Martesa, familja, seksualiteti, natyra*, Tiranë 2012, 273.

¹² Anthony Giddens, *Sociologjia*, Tiranë, Çabej 2007, 174.

¹³ Po aty.

Përkundër të gjithave, sot, gruaja në krahasim më të kaluarën tradicionale, aktivitetin e saj nuk e ka të kufizuar vetëm brenda hapësirës së banimit dhe e lidhur vetëm me punë shtëpiake, por, ajo tashmë ka edhe përgjegjësi menaxhuese të familjes, e po ashtu edhe përgjegjësi publike e politike. Natyrisht këto ndryshime, respektivisht përmirësimi i pozitës së saj shoqërore dhe publike paraqesin një vlerë për zhvillimin e përgjithshëm shoqëror por edhe përmirësimin e mirëqenies së familjes në veçanti. Të gjitha këto ndryshime, ndodhën si rezultat dhe krahas zhvillimeve dhe transformimeve që pasuan përgjatë periudhës së pasluftës (1998-1999).

Në Kosovë, pas luftës së fundit (1998-99), ndodhën ndryshime të dukshme në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë, qoftë shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike, deri në shpalljen e Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, kur Kosova ishte nën mbikëqyrjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Në këtë rast, nga zyrat ndërkombëtare të vendit, në koordinim më përfaqësuesit e Kosovës, u themeluan institucione publike, si dhe departamente e zyre, të cilat merreshin me çështje gjinore të vendit. Kështu, më këto organizata e iniciativa të vet gruas filloi një fazë e re e ndryshimeve në jetën e grave.

Rreth këtyre ndryshimeve në pozitën e gruas, studiuesi, Tahir Latifi, në studimin dhe hulumtimin e tij, ndër të tjera shtron problemin e familjes dhe gjinisë në periudhën krahasuese të socializmit (periudhë e cila më herët është e hulumtuar nga studiuesja Berit Becker po në të njëjtin fshat, në Isniq), me periudhën krahasuese të mbasluftës së fundit në Kosovë (1998-1999). Tahiri, ka theksuar se: "... shteti kosovar është i dobët dhe ka kapacitete shumë të kufizuara në ofrimin e sigurisë shoqërore për qytetarët e tij, dhe veç tjerash, ligji zakonor ende mbizotëron për shumë shqiptarë të Kosovës. Sidoqoftë, sipas tij, ka indikacione për një dobësim të marrëdhënieve patriarkale, veçanërisht nëse krahasojmë gjendjen bashkëkohore më atë të periudhës së paraluftës në Kosovë (1998-99)".¹⁴ Po ashtu, studiuesi Latifi për ndryshimet në pozitën e gruas gjatë kësaj periudhe thekson se: "*Vërehet një numër i shtuar i grave që kontribuojnë në buxhetin e familjes. Për më tepër, që nga lufta, disa familje përbëhen vetëm nga*

¹⁴ Tahir Latifi, *Gender and Family Relations: www.The Question of Social Security in Kosovo, The Gender and Sexuality Hub 'Femininities and Masculinities'* 2014, 92.

*gratë dhe fëmijët e tyre, prandaj ato kujdesën ekskluzivisht për familjet e tyre. Sot, duket se ekziston një tendencë në rritje me gratë që, jo vetëm janë kontribuuese në buxhetet familjare, por ato madje vetë administrojnë të ardhurat e tyre dhe kanë përfituar, pjesërisht, nga ligjet e reja të trashëgimisë”.*¹⁵ Sidoqoftë, ndryshimet në jetën e gruas në mes traditës dhe modernes, vazhduan të bëhen ndër vite edhe nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm dhe të njohur për ne. Studiuesi Tahir Latifi për këto ndryshime thotë se: “Ka indikacione për një dobësim të marrëdhënieve patriarkale, veçanërisht nëse krahasojmë gjendjen bashkëkohore me atë të periudhës së paraluftës në Kosovë (1998-99)”.¹⁶

Roli i gruas në shoqërinë moderne u përmirësua dukshëm, por jo në nivelin e duhur. Janë disa çështje që kanë ndikuar në përmirësimin e rolit dhe pozitës së gruas, si: ajo e kulturave të huaja moderne evropiane, shkuarjet dhe ardhjet, migrimet e shumta, dhe pranimi i këtyre ndryshimeve nga vetë shoqëria kosovare. Më një fjalë, është duke u bërë një vetëmancipim dhe prekje e realitetit jetësor nga ana e gruas edhe përkundër faktit që është paragjykes dhe mjaft sfidues. Emancipimi i gruas: “*Në përmasa më të mëdha, mori hov sidomos nga mesi i shek. XIX, ku rol të veçantë luajtën edhe lëvizjet e grave, të cilat ndikuan, jo vetëm për afirmimin e të drejtave të tyre, por edhe për emancipimin dhe interesat e mbarë shoqërisë. Parimisht, ato gjithmonë ishin lëvizje humaniste, sepse synonin lirinë shoqërore dhe çlirimin e potencialeve intelektuale të tyre. Më përpjekjet e grave, por edhe të shoqërisë u arritën rezultate të konsiderueshme në arsimimin dhe emancipimin e gruas në tërësi. Megjithatë, diskriminimi dhe skllavërimi shumëshekullor i saj, ende nuk arrin të tejkalohen plotësisht, sidomos në rajone të varfra dhe patriarkale të botës”.*¹⁷ Ndër të tjera, si ndikues i madh në ndryshimet e bëra, pa dyshim konsiderohet zhvillimi industrial, i cili në shkencat shoqërore rezultoi me teori të ndryshme lidhur me proceset ekonomike, shoqërore e kulturore, siç janë procesi i modernizimit, urbanizimit dhe së fundi globalizimit. Por, përveç ndryshimeve apo tentimit të këtyre ndryshimeve në jetën e gruas, ajo çka duhet theksuar dhe do vëmendje shumë të madhe është edhe ndryshimi i bazës familjare që pothuajse

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Hajrullah Koliqi, *Gruaja ndër shekuj, Arsimimi dhe emancipimi i saj*, 27-28.

vërehet në dhjetë vjetët e pasluftës së fundit në shoqërinë kosovare. Prandaj, ekzistojnë një mori faktorësh që u zhvilluan dhe ndikuan në vazhdimësi në ndryshimet për familjen nga një periudhë në tjetrën. Ndryshimet e tilla janë evidente edhe te jeta e gruas në përgjithësi.

Sidoqoftë, pas luftës së fundit, gratë shqiptare, dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm, pozita e gruas u përmirësua mjaft dhe vazhdon në një tempo zhvillimi më të mirë. Sot, me të drejtë mund të thuhet së pavarësisht rolit të saj në mes traditës dhe modernes, familjes dhe shoqërisë, ajo gëzon mundësinë e përfaqësimit në organet e larta të vendit, në politikë, në institucione shtetërore dhe në të gjitha sferat tjera ku kontributi i saj vlerësohet lart. Gruaja kosovare, aktivitetin e saj nuk e ka të kufizuar vetëm brenda hapësirës së banimit dhe natyrshëm e lidhur vetëm me punë shtëpiake, por, ajo tashmë ka edhe përgjegjësi menaxhuese të familjes, e po ashtu edhe përgjegjësi publike e politike. Nga kjo, bazohet fakti që sot gruaja më nuk është dhe nuk shikohet vetëm si një nënë amvise, dhe duke bërë krahasime me të kaluarën e gruas shqiptare, tashmë me transformimet e mëdha shoqërore, kemi edhe gruan si një subjekt mjaft aktiv i kyçur në jetën publike, faktor ky i cili ka ndryshuar rrënjësisht raportet gjinore, përfshirë familjen dhe vetë rolin e saj si nënë por në raste edhe nënë në rolin e kryefamiljares. Sa komplekse po aq dhe me interes, kjo tematikë ngërthen funksionimin e vlerave kulturore shikuar në perspektivë të traditës dhe modernes.

Gruaja shqiptare karakterizohet nga guximi, vendosmëria dhe dashuria për familjen. Ajo është simbol i forcës dhe i sakrificës njerëzore në kulturën shqiptare. Gruaja shqiptare shpesh trajtohet me respekt dhe adhurim në traditën shqiptare. Në familje, ka rolin thelbësor si kujdestare e fëmijëve dhe mbajtëse e vlerave familjare. Megjithatë, duhet theksuar së përvoja e secilës grua mund të ndryshojë dhe disa ende mund të hasin në sfida të ndryshme në shoqëri. Roli i gruas në familje dhe shoqëri është në ndryshim mes traditave dhe modernitetit. Në kontekstin tradicional, ajo mund të ketë përgjegjësi kryesisht në sferën e kujdesit për familjen dhe shtëpinë. Megjithatë, me avancimin e shoqërisë moderne, shumë gra tani angazhohen në karrierë, arsim dhe ndikojnë pozitivisht në zhvillimin shoqëror. Kështu, roli i gruas ka evoluar duke u përshtatur me kontekstin aktual.

Gjithashtu, si përfundim themi që nëse i kemi parasysh të gjitha rrethanat historike në të cilat është zhvilluar shoqëria shqiptare kosovare dhe sfidat me të cilat është ballafaquar ndër vite, veçanërisht me prurjet e kulturave të ndryshme ndër shekuj, pastaj pasoja e pushtimeve të ndryshme, atëherë del se edhe gruaja shqiptare, pavarësisht të gjithave ka mbijetuar më një ndjenjë sakrifice për familjen, mjedisin e shoqërinë, por ka treguar edhe gatishmëri që të gjithë dijen dhe forcën e saj ta shkrijë në favor të një mirëqenie të përbashkët, duke u sakrifikuar por edhe duke luftuar për të drejtat jo vetëm të saj si pjesë e shoqërisë por edhe të gjithë familjes dhe kombit.